


Akademie Lokale e Dialogut e OSBE-së për Gratë e Reja

# THIRRJE PËR APLIKIM

» Nga data 8 deri më 13 qershor 2019, Hotel Ulpiana, Graçanicë



## Rreth Akademisë së Dialogut Lokal të OSBE-së për Gratë e Reja

Edicioni i parë i Akademisë së Dialogut Lokal të OSBE-së për Gratë e Reja ofron platformë për gratë e reja për të kapërcyer pengesat në komunikim, për të thyer stereotipet dhe për të vendosur bazë për dialog të mëtejshëm përmes të mësuarit nga njëri tjetri, dhe aktivitetave të trajnimit dhe mentorimit. Ajo synon të rrisë komunikimin në rrjet ndërmjet komuniteteve duke u fokusuar në çështje të përbashkëta shqetësuese, në veçanti që kanë të bëjnë me barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave.

### Kualifikimet

Thirrja është e hapur për gra të reja mes moshave 16 dhe 22<sup>1</sup> vjeç nga Kosova të interesuara për të marr pjesë në proceset e politikës dhe vendimmarries, vullnetarizmit, punës në komunitet dhe avokimit. Aftësitë e gjuhës angleze nuk janë të detyrueshme.

1. Të miturve do t'u kërkohet të dërgojnë pëlqimin e prindërve të nënshkruar nga të dy prindërit (nëse është e aplikueshme) dhe formulari për këtë mund të gjendet në pakon e aplikimit.

### Struktura dhe tema

Akademia e Dialogut Lokal e OSBE-së parashev dy ditë për ndërtim ekipo dhe katër ditë trajnim nga njeri tjetri dhe interaktiv, duke mbuluar tema si barazia gjinore, fuqizimi i grave, pjesëmarrja në procesin e vendimmarries publike dhe politike, udhëheqja, si dhe trajnim për shkathtësi praktike.

Përmes moduleve të mësimit interaktiv, pjesëmarrësit do ta kenë mundësinë të zgjerojnë njojuritë e tyre në fushën e fuqizimit të gruas, udhëheqjes dhe ndërtimit të urave të komunikimit për një shoqëri të qëndrueshme. Temat që do të mbulohen përfshijnë:

- Masat e ndërtimit të mirëbesimit;
- Fuqizimi dhe pjesëmarrja e grave në proceset publike të politikëbërjes dhe vendimmarries;
- Dialogu dhe zgjidhja e konfliktit;
- Ushtime profesionale të ndërtimit të ekipit;
- Shkathtësi praktike (si të shkruani letër motivuese, CV, etj.).

### Aranzhimet

Të gjitha shpenzimet në lidhje me pjesëmarrjen në Akademinë e Dialogut Lokal të OSBE-së do te mbulohen nga Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, përfshirë transportin, ushqimin, pijet freskuese, akomodimin si dhe koston e modulit të kursit.

### Aplikacioni

Për informata shtesë ju lutemi viziton faqen e internetit të Misionit të OSBE-së në Kosovë

[www.osce.org/mission-in-kosovo](http://www.osce.org/mission-in-kosovo), ose portalin e financimit për Kosovën <https://kosovofunding.org/>.

# A po vjen? Shumë mirë, apliko tan!

» Ju lutemi dërgoni aplikacionin tuaj deri më 15 maj 2019 (23:59) në [localDA-OMiK@osce.org](mailto:localDA-OMiK@osce.org)